



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 6 paragrafi 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 34 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e datës 31 tetor 2022, përkatësisht në vazhdimin e mbledhjes më 07 nëntor 2022, mori këtë,

### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD-HOC PËR HARTIMIN E DRAFT PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

##### Neni 1

1. Me këtë vendim formohet komisioni ad-hoc për hartimin e Draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2023, dhe atë në këtë përbërje;

- 1.1. **Hilmi Hoxha**, Kryesues i Kuvendit të Komunës, kryesues i komisionit
- 1.2. **Fitim Muçolli**, anëtar nga radhët e Kuvendit - LVV
- 1.3. **Endritë Murati**, anëtare nga radhët e Kuvendit - PDK
- 1.4. **Arbnor Fazliu**, anëtar nga radhët e Kuvendit - AAK
- 1.5. \_\_\_\_\_, anëtar nga radhët e Kuvendit - LDK
- 1.6. **Antoneta Ejupi**, anëtare nga radhët e Ekzekutivit
- 1.7. **Fatlum Osmani**, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
- 1.8. **Avni Fetahu**, anëtar nga radhët e Ekzekutivit

##### Neni 2

Komisioni sipas këtij vendimi, përgatit draftin fillestar të Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, organizon konsultime publike si dhe zhvillon të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në hartimin final dhe procedimin në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

##### Neni 3

Komisioni bashkëpunon dhe koordinon me Ekzekutivin e Komunës dhe shërbimet përkatëse në kuadër të Institucionit të Komunës së Podujevës.

##### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit.

##### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-020/04-0093833/22  
Podujevë, datë; 07 nëntor 2022



Kryesuesi i Kuvendit  
**Hilmi Hoxha**